



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VIII
Sesioni vjeshtor

Kryesia e Kuvendit

P-020

Prishtinë, më 29 shtator 2021, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

IMBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 29 SHTATOR 2021

Në mbledhje morën pjesë: Glauk Konjufca, kryetar i Kuvendit; Bedri Hamza, Kujtim Shala dhe Bekim Arifi, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare në mbledhje morën pjesë: Abelard Tahiri, Armend Zemaj dhe Besnik Tahiri.

Në mbledhje ishin të pranishëm: Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, Ismet Krasniqi, si dhe stafi përgjegjës në mbështetje të Kryesisë së Kuvendit.

Mbledhjen e drejtoi Glauk Konjufca, kryetar i Kuvendit.

Me propozimin e kryetarit, Kryesia i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit, e mbajtur më 13 shtator 2021,
2. Pikat e papërfunduara nga seancat plenare, të mbajtura më 16, 19, 21, 28 korrik dhe 6 gusht 2021,
3. Pika e papërfunduara nga seanca plenare, e mbajtur më 12 gusht 2021,
4. Përgatitjet për seancë të re plenare,
5. Shqyrtimi i propozimeve dhe i kërkesave.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit, e mbajtur më 13 shtator 2021

Kryesia e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit, e mbajtur më 13 shtator 2021.

2. Pikat e papërfunduara nga seanca plenare, e mbajtur më 16, 19, 21, 28 korrik dhe 6 gusht 2021

Kryetari i njoftoi të pranishmit me pikat e papërfunduara nga seanca plenar, e mbajtur më 16, 19, 21, 28 korrik dhe 6 gusht 2021.

Në lidhje me pikat e papërfunduara të kësaj seance plenare, diskutuan: nënkryetari i Kuvendit, Kujtim Shala, përfaqësues i GP të LDK-së; Armend Zemaj, kryetar i GP të PDK-së; Abelard Tahiri dhe kryetari i GP të AAK-së, Besnik Tahiri, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas diskutimeve të lartshënuara, Kryesia përsëri edhe në këtë mbledhje nuk vendosi për datën e mbajtjes së vazhdimit të seancës plenare me pikat e papërfunduara më 16, 19, 21, 28 korrik dhe 6 gusht 2021, me qëllim të arritjes së konsensusit mes grupeve parlamentare për miratimin e pikave të papërfunduara.

3. Pika e papërfunduar nga seanca plenare, e mbajtur më 12 gusht 2021

Kryesia vendosi që vazhdim i seancës plenare me pikën e papërfunduar më 12 gusht 2021 të mbahet të hënën, më 4 tetor 2021, në orën 10:00, me këtë:

Rend dite

8. *Votimi i raportit vjetor të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës për vitin 2020.*

* * *

Përfaqësuesi i GP të LDK-së, Armend Zemaj, e shtroi çështjen e mosprocedimit në Kuvend nga Qeveria të një marrëveshjeje ndërkombëtare në lidhje me financimin për furnizim me ujë të pijshëm në komunën e Gjilanit, të cilën çështje në mbledhjen e mëparshme të Kryesisë së Kuvendit e kishte shtruar edhe Arben Gashi, kryetar i këtij grupi parlamentar.

Diskutimi i deputetit Armend Zemaj është dhënë i plotë në transkript.

Në lidhje me çështjen e shtruar nga përfaqësuesi i GP të LDK-së, Armend Zemaj, diskutoi kryetari i Kuvendit, Glauk Konjufca, diskutimi i të cilit është i dhënë në transkript.

Po ashtu, kryetari i GP të AAK-së, Besnik Tahiri, i njoftoi të pranishmit se ky grup parlamentar e ka përgatitur inicimin e një debati parlamentar në lidhje me gjendjen në veriun e Kosovës, diskutimi i të cilit është dhënë i plotë në transkript.

Në lidhje me njoftimin e kryetarit të GP të AAK-së, Besnik Tahiri, kryetari i Kuvendit tha se kjo çështje fillimisht le të diskutohet ndërmjet grupeve parlamentare.

Diskutimi i plotë i kryetarit të Kuvendit është dhënë në transkript.

* * *

4. Përgatitjet për seancë të re plenare

Kryesia, pasi i shqyrtoi përgatitjet e nevojshme, vendosi që seanca e re plenare e Kuvendit të Republikës së Kosovës të mbahet gjithashtu të hënën, më 4 tetor 2021, në orën 10:15, me këtë:

Rend dite

1. *Deklarimet jashtë rendit të ditës,*
2. *Pyetjet parlamentare,*
3. *Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme,*
4. *Shqyrtimi i Projektligjit nr. 08/L-030 për ratifikimin e amendamentimit të Marrëveshjes së bashkëfinancimit për Projektin “Programi mbështetës për ujësjellës dhe kanalizim në zonat rurale faza (dalëse) VI”, ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Zvicrës,*
5. *Shqyrtimi i Projektligjit nr. 08/L-031 për ratifikimin e Marrëveshjes së Financimit “Projekti Emergjent i Kosovës për COVID-19 - Financim shtesë” ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim,*
6. *Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-003 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.06/L-057 për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve,*

7. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-029 për punimet nga metalet e çmuara,*
8. *Shqyrtimi i Programit Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (PKZMSA) 2021 - 2025,*
9. *Shqyrtimi i Planit të Veprimit për zbatimin e fazës së dytë të prioriteteve politike të dakorduara ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Republikës së Kosovës-Agjendës për Reforma Evropiane,*
10. *Shqyrtimi i Raportit me rekomandime, në lidhje me Raportin e auditimit të performancës “Transparenca dhe llogaridhënia në procesin e financimit të organizatave joqeveritare”,*
11. *Shqyrtimi i Raportit me rekomandime, në lidhje me Raportin e auditimit të performancës “Parandalimi dhe reagimi i situatave emergjente: Vërshimet”,*
12. *Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një (1) anëtar të Bordit të ankesave të mediave.*

Po ashtu, në lidhje me pikën 12 të lartshënuar, Kryesia nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

1. Kërkohet nga grupet parlamentare të Kuvendit që para se të mbahet seanca plenare më 4. 10. 2021, t'i propozojnë deputetët për kryetar, zëvendëskryetar të parë dhe të dytë, si dhe për anëtarë të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një (1) anëtar të Bordit të Ankesave të Mediave.
2. Përbërja e Komisionit ad hoc do të jetë, si në vijim: GP i LVV-së, kryetarin (i cili nuk duhet të jetë kryetar i ndonjë komisioni parlamentar) dhe katër (4) anëtarë; GP i PDK-së, dy (2) anëtarë; GP i LDK-së, një (1) anëtar; GP i Listës serbe, zëvendëskryetarin e parë; GP i AAK-së, zëvendëskryetarin e dytë dhe GP Multietnik, një (1) anëtar.

5. Shqyrtimi i propozimeve dhe i kërkesave

1. Ndarja e kryesimeve të grupeve të miqësisë

Kryesia e shtyu shqyrtimin e pikës së lartshënuar për një mbledhje të ardhshme të Kryesisë së Kuvendit.

2. Shqyrtimi i kërkesës për mbulimin e shpenzimeve nga vizita zyrtare e kryetares së Kuvendit të Shqipërisë në Kosovë

Kryesia, pasi diskutoi në lidhje me kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Miratohet kërkesa me nr. 08/674/Do-394, e datës 23. 9. 2021 për mbulimin e shpenzimeve të akomodimit për delegacionin pesë (5) anëtarësh të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, si dhe të

drekës zyrtare të shtruar për nder të këtij delegacioni në lidhje me vizitën zyrtare të realizuar në Kosovë, nga data 21 - 22 shtator 2021.

3. Raport i deputetes Shqipe Mehmeti-Selimi në lidhje me udhëtimin zyrtar të realizuar në Hungari

Kryesia është njoftuar me shkrim nga deputetja Shqipe Mehmeti-Selimi për udhëtimin zyrtar të realizuar në Budapest të Hungarisë, më 5 - 6 shtator 2021, për pjesëmarrjen e saj në Forumin Parlamentar për Inteligjencë dhe Siguri.

4. Rishpallja e konkursit publik për shtatë (7) anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës

Kryesia, pasi diskutoi në lidhje me rishpalljen e konkursit publik për shtatë (7) anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, mori këtë:

V E N D I M

1. Rishpallet konkursi për shtatë (7) anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, prej tyre së paku dy (2) anëtarë duhet të jenë nga radhët e komuniteteve joshqiptare dhe së paku dy (2) anëtarë duhet të jenë të gjinisë femërore.
2. Ngarkohet Administrata e Kuvendit që në bazë të dispozitave të Ligjit nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ta publikojë rishpalljen publike të këtij konkursi.
3. Kandidatët që kanë aplikuar gjatë periudhës 23 gusht - 13 shtator 2021 nuk kanë nevojë të sjellin dokumentacion shtesë përveç plotësimit të aplikacionit, si rikonfirmim i aplikimit.

Pika shtesë:

Punësimi i një zyrtari për Programin e edukimit qytetar

Kryesia, pasi diskutoi në lidhje me punësimin e një zyrtari për Program të edukimit qytetar, mori këtë:

V E N D I M

Për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit nr. 08-V-017, datë 31 maj 2021

1. Pika 2 e Vendimit nr. 08-V-017, datë 31 maj 2021, ndryshohet, si në vijim:
 - 1.1. "Punësohen gjashtë (6) zyrtarë për Programin e edukimit qytetar me status të stafit mbështetës politik, me koeficient 7.
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kryesia e Kuvendit.

Të ndryshme:

Kryetari i GP të PDK-së, Abelard Tahiri, e shtroi çështjen e mosprocedimit në seancë plenare të Kuvendit pikën për propozimin e dy (2) kandidatëve për gjyqtarë në Gjykatën Kushtetuese. Diskutimi i tij i plotë është dhënë në transkript.

Kryetari e mbylli mbledhjen e Kryesisë në orën 11:05 minuta.

Glauk KONJUFCA

Kryetar i Kuvendit

Procesverbalin e hartoi:

Drejtoria për Çështje Plenare dhe Procedurale